



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Belediyesi Prizren

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

R A P O R T I I P U N Ë S

JANAR – DHJETOR 2010

Kryetari i komunës,
Prof. dr. Ramadan Muja

Prizren,
Dhjetor 2010

Gjatë vitit kalendarik 2010 kam realizuar në tërësi objektivat programore dhe politike të planifikuara përmes projeksioneve buxhetore, për realizimin e projekteve nga sektorë të ndryshëm me interes për qytetarët e komunës sonë. Prioritet i politikave publike, për mua dhe kabinetin tim qeverisës, kanë qenë ngritja e cilësisë së shërbimeve komunale administrative dhe realizimi i kërkesave të qytetarëve për projekte në infrastrukturë të përgjithshme jetësore.

Si kryetar komune, vitin 2010 e quaj vit për qytetarin dhe problematikën e tij. Projektet tona në epiqendër të vëmendjes kanë qytetarin, familjen e tij, komunitetin, problematikën e tij; fshatrat, lagjet, mjediset urbane, shkollat, rrugët, kanalizimet, rrugicat, gjelbërimin, pastrimin etj. Kujdesi ndaj qytetarit dhe familjes si institucion themelor i shoqërisë, mbeten angazhime të mëtejme për mua dhe institucionin që udhëheq. Vendimmarrja komunale gjatë këtij viti është karakterizuar edhe me krijimin e hapësirave sa më të mëdha për mendim profesional të ekspertëve nga fushat e ndryshme që veprojnë në komunë dhe më gjerë. Qëllimi i vetëm ishte që, përmes konsultave profesionale, projektet tona t'i përmbushnin kërkesat dhe pritjet e qytetarëve.

Këtë praktikë konsultative e kemi realizuar duke komunikuar drejtpërdrejt me qytetarët në zyrën time të punës, në debate të hapura publike në komunë, në debate publike në zona të ndryshme të komunës sonë si në: qytet, në Has, Zhupë, Vërrin, Përdriin etj. Gjatë vitit 2010 jam angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivelin më të lartë të transparencës komunale dhe jam kujdesur që praktikat më të avancuara demokratike të aplikohen gjatë vendimmarrjes në qeverinë komunale.

Të gjitha vendimet, nga të gjithë sektorët komunalë, në të njëjtën ditë që janë marrë, janë bërë publike për audiencën qytetare dhe atë profesionale në Web faqen e komunës. Jemi duke punuar intensivisht në digjitalizimin e shërbimeve dhe krijimin e data - bazës së të dhënave kompjuterike, në mënyrë që qasja në dokumente të komunës dhe nevoja për dokumente komunale, të mundësohet në mënyrë elektronike, nga mjediset familjare të qytetarëve tanë dhe mërgatës sonë.

Komuna jonë, gjatë vitit 2010, ka realizuar shumë projekte në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë si "USAID"-in, "GTZ"-në, "TIKA"-an, "CHF"-në, etj. Fokus i projekteve ishte infrastruktura kabinetike shkollore, zgjerimi i hapësirave për mësim, uji i pijes, infrastruktura urbane etj.

Gjatë vitit 2010, komunën tonë e kam prezantuar në shtete të ndryshme të Evropës me të arriturat tona dhe sigurisht edhe me nevojat për investime të mundshme nga jashtë. Më ftesë të UNDP-së, kam vizituar disa komuna në Suedi, si Faluna, Stokholm etj. Qëllimi i vizitës ka qenë shkëmbimi i përvojave dhe praktikave në funksionimin e administratës, gjegjësisht rritja e kapaciteteve në administratën komunale.

Po ashtu, gjatë këtij viti kam vizituar edhe Gjermaninë, gjegjësisht komunën e Hamburgut, ku kam marrë pjesë në seminarin, "Organizimi i punës praktike nëpër shkollat profesionale". Konsideroj se një praktikë e tillë mund të aplikohet edhe në shkollat tona profesionale dhe, pas kthimit nga ky seminar, kam diskutuar me drejtorinë e arsimit që praktikat e tilla, nëse janë të mundura, të aplikohen edhe në shkollat tona.

Gjatë muajit korrik 2010, së bashku me një delegacion nga ekzekutivi komunal dhe kuvendi i komunës kemi bërë një vizitë tjetër në Kroaci, në Komunën e Osjekut. Fokus kryesor i vizitës ishte rritja e bashkëpunimit në mes të Komunës së Prizrenit dhe Komunës së Osjekut në fushën e zhvillimit ekonomik, kulturor, sportiv etj.

Kam qenë për vizitë në Francë me një delegacion nga ekzekutivi komunal. Kemi vizituar disa qendra turistike malore dhe jemi takuar me ekspertë të turizmit malor francez. Pretenca e kësaj vizite ishte shfrytëzimi i praktikave franceze rreth zhvillimit dhe organizimit sa më të mirë në fushën e turizmit malor, akomodimin, organizimin e jetës malore gjatë stinës së dimrit dhe mundësitë e shfrytëzimit të potencialit malor edhe gjatë stinëve të tjera.

Agjendës politike vendimmarrëse, për shpalljen e personaliteteve të ndryshme botërore me çmimin “Qytetar Nderi i Prizrenit”, të cilin e ndanë komuna, këtë vit e kemi nderuar kryeministrin e shtetit Turk, z. Recep Tyayp Erdogan.

Ceremonia e shpalljes Qytetar Nderi i Prizrenit është mirëpritur nga qytetarët e komunës sonë dhe është vlerësuar shumë lart edhe nga protokolli i shtetit të Turqisë.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës, komuna jonë këtë vit ka treguar efikasitet të lartë në mbledhjen e tatimit në pronë dhe mbledhjen e taksës komunale.

Parashikimet tona për vitin 2010 në grumbullimin e tatimit në pronë janë realizuar rreth 108 %. Taksat komunale për veprimtari zejtare dhe tregtare, gjithashtu, janë realizuar në lartësi prej 106 %.

Këtë lartësi të përqindjes e kemi realizuar duke bashkëpunuar ngushtë me qytetarët dhe duke marrë vazhdimisht në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet e tyre për modalitetet më të mira dhe më të lehta që ata të mund të paguanin obligimet e tyre ligjore, pa e rrezikuar biznesin dhe afarizmin e tyre.

Ju informoj se, gjatë vitit 2010, komuna jonë ka pasur një buxhet prej 26.400.000,00 €.

Prej tyre, 12.000.000,00 € kanë qenë të rezervuara për investime kapitale. Investime të cilat janë realizuar mjaft mirë, në kohë të caktuar dhe sipas planifikimeve të parapara, së bashku me ju anëtarë të respektuar të kuvendit të komunës.

Gjatë shpenzimit të buxhetit kemi qenë vigjilentë dhe shumë të kujdesshëm, që paranë e taksapaguesve ta harxhojmë me korrektësinë më të madhe ligjore dhe duke ruajtur dinamikën e projekteve për realizim.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës, tani më lejoni që para jush të paraqes të hyrat sipas drejtorive, gjatë viti 2010

Të hyrat sipas drejtorive, gjatë viti 2010	Planifikimi	Realizimi I-XII-2010	%
Administrata dhe Personeli	746,300.00	707,949.22	94.86
Inspeksioni	20,871.00	13,606.36	65.19
Buxheti dhe Financat	1,580,000.00	1,712,289.05	108.37
Shërbimet Publike , Mbrojtja civile, Emergjencia	1,506,364.00	1,385,775.40	91.99
Bujqësia , Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	25,000.00	26,579.80	106.32
Kadastra dhe Gjeodezia	308,000.00	208,034.75	67.54
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	977,700.00	438,304.74	44.83
Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	200,000.00	191,681.00	95.84
Kulturë, Rini dhe Sport		366,761.82	
Arsimi dhe Shkenca- Administrata	150,000.00	118,391.00	244.51
Gjithsej	5,514,235.00	5,192,146.89	94.16

Drejtoria e Administratës, gjatë vitit 2010, prioritet kishte ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale dhe digjitalizimin e të dhënave, ngritjen e performancës në punë dhe qytetarin në qendër të vëmendjes.

Kjo drejtori ka ndërtuar dhe funksionalizuar zyrat e gjendjes civile në Zhur, në Hoçë të Qytetit, në Piranë, në Romajë dhe Velezhë. Administrata komunale tani operon me 12 zyra të gjendjes civile nëpër bashkësi lokale dhe fshatra të komunës sonë. Qytetari i Komunës së Prizrenit nuk ka nevojë të ngarendë nga fshati në komunë për ta vulosur një certifikatë a dokument tjetër, ngase, të gjitha këto dokumente dhe shërbime komunale në formën finale të tyre i merr në vendbanimin e tij.

Gjatë vitit 2010, administrata komunale ka përpunuar 3085 lëndë të ndryshme si: autorizime, deklarata, garancione, pëlqime, certifikata, dëshmi, vërtetime dhe lëndë të tjera që lëshohen në bazë të procedurës së paraparë.

Sektori i gjendjes civile në administratën komunale këtë vit ka lëshuar 95.000 certifikata të lindjes, 16.000 certifikata të martesës, 4.000 certifikata të vdekjes, 3.700 certifikata për status martesor, 38.459 certifikata të shtetësisë dhe 7.770 certifikata të vendbanimit. Në kuadër të administratës është edhe sektori pronësor-juridik, në këtë sektor janë pranuar 1.101 lëndë, prej tyre janë aprovuar 1.067 lëndë, janë në procedurë e sipër dhe 34 lëndë të mbetura për 2011.

Analitikën e të gjitha lëndëve të pranuar dhe të realizuara, gjatë vitit 2010, e gjeni në raportin detal të Drejtorisë së Administratës, plasuar në Web faqen e komunës.

Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bashkëpunim të ngushtë me Qendrën për Punë Sociale. Ajo ofron shërbime sociale dhe familjare, ka bërë strehimin e përkohshëm të familjeve në nevojë, përkujdeset për fëmijët bonjakë dhe bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare.

Si punë permanente, kjo drejtori ka përkujdesjen ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës së fundit, familjarëve të dëshmorëve, familjeve që kanë mbetur pa strehë, mirëmbajtjen e strehimore, ku janë të vendosura 22 familje me 105 anëtarë. Kjo drejtori ka bërë furnizimin me material ushqimor dhe higjienik për familje të dëshmorëve, furnizimin me dru për familjet e dëshmorëve dhe ka organizuar iftar gjatë gjithë muajit të ramazanit, për familjet në nevojë. Ka bërë furnizimin me artikuj ushqimorë dhe higjienikë edhe për invalidët e luftës, ka furnizuar me dru invalidët e luftës, ka siguruar material ndërtimor për rastet sociale. Gjithashtu, ka siguruar edhe dhurata për Vitin e Ri 2011 për fëmijët bonjakë të komunës sonë.

Drejtoria e Arsimit gjatë vitit 2010, bashkë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka investuar 7.000.000,00 €, për ndërtimin e shkollave të reja në komunën tonë. Drejtoria e arsimit ka operuar me buxhet, në vlerë prej 10,715,454,00 €, deri më 31 dhjetor, shprehur në %, buxheti është shpenzuar 99.55% .

Drejtoria e Arsimit për investime Kapitale ka shpenzuar 1.745.354,99 nga 1.748.654,00 të planifikuara. Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar katër shkolla , dy anekse, si dhe janë rinovuar disa objekte shkollore: Shkolla të reja: Në Kojush në vitin 2010 është paguar 151807,32 €, Shkolla e Atmaxhes në vitin 2010 është paguar në vlerë prej 388030,82 €. Faza përfundimtare e shkollës në Nashec në vlerë prej 471.138,78 €, Faza e parë e ndërtimit të shkollës në Kobajë e paguar në vitin 2010 115.700,00 €.

Ndërtimi i anekseve në bashkëpunim me CHF-në (Mati Logorec dhe Motrat Qiriaz) 350.109,17 € pagesa nga Komuna e Prizrenit pa llogaritur participimin nga CHF-ja. Gjatë vitit 2010 në disa shkolla është intervenuar edhe në renovime si dyer e dritare, nyje sanitare, rregullime të oborreve shkollore, instalim të nxehjeve qendrore në vlerë 217.269,76 €. Nga punimet e kryera kemi mbetur borxh punëkryesëve, 65.865,99 €. Gjatë vitit 2010 është bërë edhe furnizimi me pajisje për shkolla në kuadër të investimeve kapitale (kryesisht banka dhe kërriga) në vlerë prej 35.598,00 €. Shkollat i kemi furnizim me lëndë djegëse për ngrohje dhe kemi bërë lysterjen e objekteve shkollore.

Me dru 2550 metra kub në vlerë prej 86190,00 €

Me thëngjill me 2000 ton në vlerë prej 158.000,00 €

Me naftë për ngrohje në vlerë prej 101.300,00 €

Në kuadër të investimeve është bërë lysterja e objekteve shkollore: 29.222,49 €.

Udhëtimi i nxënësve në disa shkolla 10.556,00 €.

Gjatë vitit 2010 janë bërë edhe disa investime nga MASHT-it, ndërtimi shkollave në lagjen “Bajram Curri”, në Nebergosht, punimet janë duke u kryer fshatin Qëndresë dhe lagjen “Bajram Curri”. Në kuadër të shpenzimeve hyjnë edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe komunalit, sipas tabelorit të mëposhtëm:

Raporti i Shpenzimeve për :Drejtoria e Arsimit		Viti 2010				
Arsimi Fillor						
Arsimi I mesem	Kodi					
		Buxheti I Alokuar		Shpenzimet	Mbetja	%
Administrata e Arsimit		1.956.364,00		1.947.673,00	8.692,00	„99,55%
PAGAT DHE SHITESAT	10-111-92050	50.344,00		50.342,00	2,00	„99,99
MALLARAT DHE SHERBIMET	10-130	6.744,00		6.743,00	1,00	„99,99%
MALLARAT DHE SHERBIMET	22	68.622,00		68.610,81	11,19	„99,98%
SHPENZIMET KOMUNALE	10-132	7.000,00		6.567,16	432,84	„94%
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	21	75.000,00		70.055,00	4.945,00	„93%
SHPENZIMET KAPITALE	10-21-22	1.748.654,00		1.745.354,99	3.300,00	„99,80%
Shkollat Fillore		6.642.675,00		6.575.666,00	67.009,70	„98,99%
PAGAT DHE SHITESAT	10-111-93271	5.816.115,00		5.803.053,00	13.063,00	„99,77%
MALLARAT DHE SHERBIMET	10-130	648.131,00		640.867,30	7.263,70	„98,80%
SHPENZIMET KOMUNALE	10-132	178.429,00		131.746,00	46.683,00	„73,80%
Shkollat e Mesme		2.116.415,00		2.082.483,00	33.931,00	„98,39%
PAGAT DHE SHITESAT	10-111-93272	1.853.836,00		1.826.334,00	27.501,00	„98,50%
MALLARAT DHE SHERBIMET	10-130	200.579,00		199.011,00	1.568,00	„99,20%
SHPENZIMET KOMUNALE	10-132	62.000,00		57.138,00	4.862,00	„92,10%
GJITHËSEJTI BUXHETI I ARSIMIT		10.715.454,00		10.605.822,00	109.632,70	„98,97%

Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjatë vitit 2010, ka realizuar 104 projekte me interes për qytetarin e komunës sonë. Prioritet ishte infrastruktura rrugore, nënrrugore, ndriçimi publik, mjediset e gjelbëruara etj.

Në vazhdim më lejoni që në mënyrë analitike të paraqes para jush disa prej projekteve të realizuara në kuadër të kësaj drejtorie:

Projekti: Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në rrugën "Tirana". Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes NPNT - "Çlirimi" nga Prizreni. Vlera e kontratës : 1,660,429.63 €

Gjatësia e rrugës është 1350 m dhe gjerësia 17m. Rruga është me katër korsitë, ka shiritin gjelbërues në mes dhe trotuar në të dy anët e rrugës. Po ashtu, në kuadër të këtyre punimeve janë vendosur edhe të gjitha instalimet nëntokësore dhe ndriçimi. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Rivitalizimi i rrugës së "Farkëtarëve" dhe punimet nëntokësore. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes: OE- N.N.T.SH. "Kosova ERH & Kotori" .- Prizren. Vlera e kontratës : 67,513.00 €

Në kuadër të këtij projekti janë ndërtuar: kanalizimi fekal, rrjeti i ujësjellësit dhe rrjeti energjetik. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve. Punimet mbitokësore në këtë rrugë janë duke vazhduar me operator tjetër ekonomik dhe pritet të përfundojnë në muajin prill, 2011.

Investitor Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes OE- N.N.SH. "Themeli" .- Prizren. Vlera e kontratës 231,689.31 €

Projekt me rëndësi për qytetarët është edhe: Ndërtimi i rrugës "Janina" – Prizren. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe MAPL-ë, punë kryes :N.N.T.P.P. "Gashi Ing" – Therandë. Vlera e kontratës : 225,238.54 €

Gjatësia e rrugës është 850 m dhe gjerësia 6m. Rruga është e shtruar me dy shtresa asfalt dhe në të dy anët e rrugës janë ndërtuar trotuare me gjerësi nga 1.5m, si dhe është ndërtuar kanalizimi atmosferik. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Ndërtimi me asfalt i rrugës Kojush-Planejë-Gorozhup: Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe MTPT-it, punë kryes : OE- "KAG – Asphalt Company" Sh.p.k. nga Prizreni. Vlera e kontratës : 1,392,221.98 €

Rruga është ndërtuar me asfalt me gjatësi prej 10.028,45m. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Ndërtimi me asfalt i rrugës "Nëna Terezë"- lagjja Petrovë në Prizren. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-N.N.P.T "Seti Commerc" dhe N.T.P. "Burimi". Vlera e kontratës : 414,123.01 €.

Në kuadër të kësaj kontrate është ndërtuar rruga me asfalt në gjatësi prej 1470m, trotuaret në të dy anët e rrugës, kanalizimi atmosferik dhe ura nga betoni i armuar. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Ndërtimi i rrugës me elemente betoni dhe asfalt në fshatin Krushë e Vogël.
Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NP "Victoria Invest International". Vlera e kontratës : ..333,723.14 €.

Në kuadër të kësaj kontrate është ndërtuar rruga me asfalt në gjatësi prej 1100m me trotuar në njërin anë dhe rrugët me kubza me gjatësi prej 1567.69m. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në fshatin Kushnin të Hasit. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NPT - "Elshani" nga Medveci
Vlera e kontratës :. 16,300.00 €. Është shtruar me elemente betoni rruga në sipërfaqe prej 1200m². Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Rehabilitimi i rrugëve me asfalt në qytetin e Prizrenit Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NNTSH "Drini Company". Vlera e kontratës, 248.5 € / njësi.

Në kuadër të kësaj kontrate janë rehabilituar gropat nëpër qytet, janë asfaltuar rrugët – shtresat e epërme, të cilat janë dëmtuar gjatë punimeve në rrjetin e ujësjellësit nga Hidroregjioni Jugor – Prizren, gjithsej janë shtruar me asfalt, 9467.6 m². Këto punime janë realizuar në vitin 2010.

Projekti: Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në lagjen "Omaj" në fshatin Zhur
Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NP "Renelual Tahiri".
Vlera e kontratës :.. 31,739.29 €. Rruga është ndërtuar me kubza me gjatësi prej 1567.69m. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Furnizimi me kubza dhe zhavorr për rrugët në fshatrat Pllanjan, Jabllanicë, Npropogost, Novosellë, Llokvicë dhe Lubinje e Poshtme.
Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes: OE- "I. Seferi" Sh.p.k.- Therandë
Vlera e kontratës : 80,985.00 €

Gjithsej janë shtruar: 6540m² kubza, 983m³ zhavorr dhe janë vendosur 2110m³ skajorë dhe 530m³ rigola. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Hoçë e Qytetit – Prizren. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NPT - "Xërxa" nga Rahoveci
Vlera e kontratës: 330,467.80 €

Pjesë të këtij projekti janë: Ndërtimi i tre kaptazhave, ndërtimi i tri pusetave shkarkuese-shpërndarëse, ndërtimi i tre rezervuarëve me kapacitet V=200m³, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit me gjatësi L=7000m³ me dimensione të tubave Ø75 – Ø90 – Ø110 – Ø160. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve, pra rrjeti i ri i ujësjellësit, së bashku me rezervuarët janë në shfrytëzim të banorëve.

Projekti: Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Serbicë e Poshtme. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NPT - "Xërxa" nga Rahoveci.
Vlera e kontratës: 143,199.92 €. Pjesë të projektit janë: ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit me gjatësi $L=7787$ m' me dimensione të tubave Ø65- Ø70- Ø90- Ø110- Ø125. Si pjesë e projektit është ndërtimi i rezervuarit me kapacitet $V=200$ m³, si dhe ndërtimi i stacionit të pompimit dhe pusit eksploatues. Projekti është përfunduar në vitin 2010 që do të thotë se është në funksion dhe banorët janë duke e shfrytëzuar projektin në fjalë

Projekti: Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatin Mushnikovë.
Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NPT - "Xërxa" nga Rahoveci. Vlera e kontratës : 73,086.78 €. Pjesë të projektit janë: Ndërtimi i sistemit të kanalizimit me gjatësi të rrjetit $L=842$ m'. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit me gjatësi $L=2400$ m' me dimensione të tubave Ø63- Ø90- Ø110. Projekti është përfunduar në vitin 2010, është në funksion dhe banorët janë duke e shfrytëzuar.

Projekti: Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Shpenadi – Prizren. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-NNP - "Iliri-Na" nga Rahoveci
Vlera e kontratës :90,386.93 €. Është ndërtuar kanalizimi fekal me gjatësi prej 1683m. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Prizrenit. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes : OE-N.N.SH. "Themeli" & N.P. "Lucino CGS" nga Prizreni. Vlera e kontratave : 79.00 € / njësi .
Gjatë vitit 2010 është bërë shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Prizrenit edhe në lagjen Arbana. E tërë vlera e këtyre punimeve të realizuara gjatë vitit 2010 është 80,000.00 € .

Projekti: Mirëmbajtja: fshirja, larja dhe pastrimi i borës nëpër rrugët e qytetit dhe fshatra. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike, punë kryes: NSH "SHËRBIMI", Shpk "Is-Company" dhe "Eko-Regjioni".
Gjatë vitit 2010 është bërë fshirja-larja e rrugëve, mirëmbajtja ambientale dhe pastrimi i borës nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit dhe fshatra. E tërë vlera e këtyre punimeve të realizuara gjatë vitit 2010 është 399,953.20 € .

Projekti: Hartimi i projektit të varrezave të reja të qytetit. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike. Hartuesi i projektit: NNP "Coneng". Vlera e kontratës : 35,280.00 € Është hartuar projekti i varrezave të reja për Qytetin e Prizrenit.

Projekti: Ndërtimi i miniparkut në lagjen "Jeni Mahalla 2" dhe miniparkut te Shkolla Teknike në Prizren. Investitor: Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Punë kryes : NSH "SHËRBIMI". Vlera e kontratës : 24,006.00 €. Është rregulluar hapësira tek lagja "Jeni Mahalla" dhe tek Shkolla teknike, pra janë larguar mbeturinat dhe është gjelbëruar sipërfaqja. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: “Modernizimi i ndriçimit publik në Komunën e Prizrenit”. Investitor: Ministria e Energjetikës dhe Minierave, GTZ -ja dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike. Vlera e kontratës : 68,800.00 €

Ky investim është bërë për hir të efijencës së energjisë elektrike. Llambat ekzistuese kanë qenë llamba pjatore me poç të Hg (zhivës) 125 W. Ndërsa llambat e reja janë me poç - LED- 28 W. Nga kjo mund të shihet se poçet e LED-it harxhojnë rrymë elektrike mbi katër herë më pak se ato të zhivës, duke mos e humbur ndriqeshmërinë e mëparshme të rrugës. Po ashtu, janë ndërruar edhe katër komanda të vjetra me komanda të reja të ndriçimit publik. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Projekti: “Ndriçimi i Kejit, përkaj Lumëbardhit, me ndriçim efijent”. Investitor: Donacion i USAID-it. Vlera e kontratës : 29,101.00 €

Përkaj “Lumëbardhit”, në të dy anët e urës së “Arastës”, në Kej, janë larguar shtyllat e vjetra dekorative së bashku me kabllimin nëntokësor dhe janë vendosur 18 shtylla dekorative të reja, trupi i të cilave është nga alumini i derdhur. Është vendosur sistemi i ri i furnizimit elektrik, ndërsa poçet e vendosura janë efijente prej 70 . Me këtë rast janë riparuar edhe ulëset ekzistuese. Punimet kanë përfunduar në vitin 2010 dhe është bërë edhe pranimi teknik i punimeve.

Kuvendarë të nderuar, një analitikë të këtillë të projekteve të tjera, e gjeni në raportin e zgjeruar dhe të detajuar, të drejtorisë përkatëse, plasuar në Ueb faqen e komunës sonë.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, ka zhvilluar një varg aktivitetesh kulturore, shoqërore, sportive dhe letrare.

Komuna ka mbështetur materialisht Teatrin Profesionist të Qytetit të Prizrenit, i cili promovon idetë dhe kërkesat e dashamirëve të artit skenik. Gjithashtu, në traditën tonë të mbështetjes materiale, ka hyrë edhe festivali Hasi Jehon, Festivali i këngëve për fëmijë Fluturat 2010 dhe Festivali rok live 2010.

Manifestimet e Qershorit janë organizuar në mënyrën më të përimituar. D.m.th. janë një varg manifestimesh për ditën e themelimit të organizatës politike dhe ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Manifestimet për ditën e Çlirimit të Prizrenit 12 Qershorin dhe manifestime të tjera. Është organizuar festivali i 22 i këngës së vjetër qytetare Zambaku i Prizrenit 2010, i cili sivjet ka qenë shumë i suksesshëm. Gjithashtu, festivali i filmit dokumentar dhe të shkurtër Doku Fest, ka gëzuar mbështetje materiale nga komuna.

Janë organizuar dhe përkrahur financiarisht Takimet e Gjeçovit 2010, është organizuar edhe përkrahur financiarisht edhe java e filmit francezë në Prizren, që ishte risi për komunën tonë edhe për qytetin tonë. Është shënuar 28 Nëntori - Dita e Flamurit, e cila ka gëzuar përkrahje financiare nga komuna.

Janë realizuar shumë pjesëmarrje në manifestime kulturore ndërkombëtare, janë organizuar një varg akademish solemne dhe përkujtimore, të gjitha këto aktivitete natyrisht edhe kulturore, kanë pasur përkrahje financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në kuadër të kësaj drejtorie janë bërë edhe investime kapitale: Është bërë rehabilitimi i mureve rrethuese të Kalasë - Kështjellës Iliro-Dardane, e cila qëndron krenare mbi qytetin tonë historik.

Është bërë rehabilitimi i Xhamisë së Sinan Pashës, është në konservim e sipër ndërtesa e vjetër e Bashkisë së qytetit, që ne qytetarët e Prizrenit e njohim si Beledije.

Është përfunduar faza e parë e ndërtimit të Art-qendrës. Është ndërtuar shtëpia e kulturës, ose pallati i kulturës në Zhur, faza e parë. Gjithashtu, është bërë edhe rregullimi i varrezave të dëshmorëve në Landovicë. Janë ndërtuar 18 varre të reja të dëshmorëve që janë zhvendosur nga varrezat e Qëndresës dhe të Krushës së Vogël.

Drejtoria në fjalë i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe aktiviteteve sportive në komunë, jo vetëm në qytetin e Prizrenit po në mbarë komunën tonë.

Janë përkrahur financiarisht këto aktivitete sportive: Është përkrahur turneu i futbollit "Ekrem Rexha", Shoqata e bjeshkatarëve "Sharri". Iu është dhënë ndihmë financiare të gjitha klubeve sportive gjatë vitit 2010; klubi i shahistëve ka gëzuar përkrahje materiale, klubi basketbollit "Bashkimi"- femrat, klubi i ping pongut të qytetit, klubi i basketbollit "Bashkimi"- meshkujt.

Gjatë vitit 2010 është bërë ndërtimi i terreneve sportive në Qendrën sportive "Sezai Surroi", kemi përkrahur turneun përkujtimor "Hajdar Shala", auto klubin "Drini", klubin e basketbollit Mega - sport, turneun përkujtimor "Sinan Thaçi", "Dete biber drushta", shoqatën e peshkatarëve sportiv, "Drini", shoqatën e biciklistëve, shoqatën "Old tajmer", takimet ndërkombëtare të bjeshkatarëve. Ju e dini se bjeshkatarët Sharri të Komunës së Prizrenit janë krenari e kësaj komune. Ata e kanë arsyetuar vetveten edhe me pushtimin e majës më të lartë të kontinentit të Afrikës në Kilimanxharo, me plot sukses kanë arritur në ato maja.

Komuna, gjatë vitit 2010, ka mbështetur financiarisht edhe turnetë në futboll të vogël, në Novoselan, turneun "Përparim Thaçi", turneun e futbollit "Zenun Çoçaj", turneun e futbollit Reçane 2010, Open Fan Futboll Skull.

Gjithashtu, janë përkrahur edhe të gjitha aktivitetet e tjera rinore.

Drejtoria e Zhvillimit dhe Turizmit, drejtori e re e cila patjetër që duhet të funksionojë si dikaster i veçantë, sepse ne pretendojmë që qytetin e Prizrenit ta shndërrojmë në qytet turistik të mirëfilltë dhe ekonomia turistike të zhvillohet me trendët, kërkesat dhe nevojat e qytetarëve vendorë dhe pjesës ndërkombëtare që vizitojnë komunën tonë.

Në kuadër të kësaj drejtorie janë zhvilluar këto aktivitete: Janë bërë takimet me zejtarët nga Prizreni, është bërë një vizitë e ekspertit të turizmit nga Franca z. Iv Pukvej, zyrtarisht kemi pritur dhe përkrahur motoçiklistët nga Evropa, në kuadër të promovimit kulturor të Prizrenit.

Gjithashtu, vizitë qytetit të Prizrenit i kanë bërë edhe Produksioni i filmit nga Turqia - Arka Siradakler, kemi organizuar pritjen e delegacionit të Tur - operatorëve nga shtetet fqinjë Mali i Zi dhe Kroacia (Dubrovniku). Zyrtarisht kemi mirëpritur delegacionin diplomatik të Ambasadës Gjermane në Kosovë dhe së bashku kemi bërë promovimin e udhërrëfyesit për Prizrenin.

Gjatë vitit 2010, është realizuar projekti turistik i katalogut informativ Prizreni - kryeqytet kulturor i Kosovës në bashkëpunim me organizatën TIK-a nga Turqia. Janë shënuar ditët e trashëgimisë evropiane në Kosovë, dhe java e mobilitetit evropian. Është organizuar Panairi i turizmit kosovar në Shqipëri, ku ka marrë pjesë aktive kjo drejtori dhe ka prezantuar nevojat turistike të komunës sonë në Shqipëri.

Gjatë vitit 2010, në zhvillimin e turizmit dhe rritjen e kapaciteteve në komunë kemi bërë promovimin e katër ciceronëve të parë, të cilët janë të nevojshëm për t'iu dhënë turistëve vendorë dhe të huaj shpjegime për historikun e monumenteve kulturo-historik të qytetit.

Drejtorja e Emergjencës dhe e Sigurisë ka bërë investime kapitale në realizimin e tre projekteve, ngritjen e tre nënstacioneve për zjarrfikës. Ka bërë pastrimin e bodrumeve të banesave kolektive në qytet, është bërë pastrimi i bodrumeve dhe i pajisjeve të jashtme nga mbeturinat kolektive pjesa e dytë, në Ortakoll dhe në lagjet e tjera të qytetit.

Gjatë vitit 2010, Drejtorja e Emergjencës dhe e Sigurisë ka realizuar disa projekte me karakter shpëtimi në mjediset kolektive dhe shpëtimin e nxënësve në rast rreziku në shkolla. Një ushtrim i tillë me emrin Evakuimi në shkollë është bërë në shkollën e Dardanisë. Ushtrimet kanë përfunduar me sukses dhe kanë treguar se zjarrfikësit tanë janë të shkathhtë dhe janë të gatshëm t'i dalin në ndihmë qytetarëve në fatkeqësi të ndryshme.

Janë bërë inspektime të rregullta, është përcjell gjendja në ndërtesat e larta kolektive, është përcjell me kujdes të shtuar, gjendja në malet e komunës sonë, është përcjell vazhdimisht dhe kujdesshëm gjendja në deponinë regjionale të mbeturinave.

Më poshtë në mënyrë tabelore, paraqesim projektet e kësaj drejtorie.

INVESTIMET KAPITALE TË DREJTORISË SË EMERGJENCËS

Pozicioni buxhetor 2010	Emri i projekteve të realizuara	Buxheti i paraparë €	Shuma e kontratës €	Mjetet e shpenzuara €
1.	Ndërtimi i tri nënstacioneve	160,000.00	166,679.28	160,000.00
2.	Pastrimi i bodrumeve të banesave kolektive, pj. I	3,142.00	3,142.00	3,142.00
3.	Pastrimi i bodrumeve dhe pajisjeve të jashtme nga mbeturinat në ndërtesa kolektive, pjesa II	9,992.00	9,992.00	9,992.00

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë vitit kalendarik 2010, ka hartuar planin zhvillimor komunal, plan i cili është në fazën e fundit të diskutimit publik. Ka bërë planin rregullues urban për shpalljen e zonës së veçantë, të zonës - Industri e lehtë, e mesme dhe e vogël në komunën tonë, apo siç e quajmë ndryshe Parku i biznesit. Plani rregullues urban për lokacionin Qendra e re dy e qytetit të Prizrenit, me të cilin parashihet ndërtimi i përzier (miks), qendër administrative, e cila përfshinë sipërfaqen prej 33 hektarë e 60 ari.

Është ndërtuar monumenti kushtuar NATO-së. Ndërtimi i varrezave të dëshmorëve në fshatin Lugishtë e Hasit, është bërë ndërtimi i monumenteve kushtuar dëshmorëve në fshatin Jeshkovë. Është rregulluar dhe është në përfundim e sipër ambienti pranë monumentit të dëshmorit Xhevat Berisha. Është bërë hartimi i projektit kushtuar dëshmorëve të lagjes Arbanë.

Është bërë rikonstruktimi i shtëpisë së Shuaip Spahisë, i cili po zhvillohet me hapa të shpejtë dhe shumë të sigurt. Jemi dëshmitarë, për çdo ditë i shohim rezultatet e reja. Është në zhvillim e sipër ndërtimi i Muzeut kushtuar Nënës Terezë, në 100 - vjetorin e lindjes së saj. Është bërë ndërtimi i platosë te ura e Arastës, fasadimi i banesave, në të cilat mbi 50 vjet askush nuk ka vënë dorë mbi to dhe kanë qenë shëmtia më e madhe e qytetit të Prizrenit. Tani, qyteti ynë, në këto pjesë, e ka marrë një pamje krejtësisht tjetër.

Projektet, të cilat janë realizuar gjatë vitit 2010, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, në mënyrë analitike i paraqesim më poshtë :

Plani Zhvillimor Komunal është në fazën IV dhe V të diskutimit publik - 35.000,00 €. Projekti i fazës së dytë “Art Qendra”, e cila është donacion me AZHR-në - 5.000,00 €. Plani Rregullues Urban, shpallja e zonës së veçantë, (Industri e lehtë, e mesme dhe e vogël) - Parku i biznesit, e cila është në fazën përfundimtare të miratimit. Plani Rregullues Urban për lokacionin “Qendra e Re - 2” të qytetit të Prizrenit, me të cilën parashihet ndërtimi miks (Qendër Administrative), e cila është në fazën përfundimtare të miratimit dhe përfshinë sipërfaqen prej S = 33,60 ha.

Hartimi i Planit Rregullativ - Tregti dhe Industri e vogël 58.300,00 €.

Ndërtimi i Monumentit të “NATOS” 55.000,00 €.

Ndërtimi i varrezave të dëshmorëve në fshatin Lugishtë e Hasit 100.000,00 €.

Ndërtimi i monumentit kushtuar dëshmorëve të fshatit Jeshkovë 51.590,90 € .

Rregullimi i ambientit pranë monumentit të dëshmorit “Xhevat Berisha” 12.449,95 €.

Rikonstruimi i shtëpisë së Shuaip Pashës - 150.000,00 € .

Projekti i muzeut kushtuar “Nënës Terezë” 3.600,00 €.

Ndërtimi i parkut përballë “Ben-afit” 14.909,44 €.

Ndërtimi i trotuarit dhe rrugës “Shuaip Spahiu” 146.982,23 €.

Ndërtimi i platos te “Ura e Arastës” 4.611,00 €.

Fasadimi i objekteve – banesave 18.675,00 € .

Renovimi i ashensorëve në objektet e banimit kolektiv – banesat - 180.000,00 €.

Ndërtimi i rrugës para hyrjes së shkollës “Emin Duraku” 15.489,00 €.

Pasqyra tabelore mbi gjendjen e vendosjes së lëndëve në procedurën administrative sipas kërkesës për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010

Numri i kërkesave për periudhën 1.1. – 31.12.2010	Kërkesat e pranuar			Kërkesat e vendosura				
	Të pranuar... 31.12.2010	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë	Procedura është	Lëndët në procedurë	gjithsej
Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikim Hapësin.	1029	1029	539	206	95	32	157	1029

Drejtoria e Shëndetësisë, gjatë vitit 2010 ka realizuar të gjitha projektet e parapara dhe të planifikuara paraprakisht. Gjatë vitit 2010 është bërë ndërtimi i ambulancës së mjekësisë familjare në lagjen “Bajram Curri”. Ambulancë të re kemi ndërtuar edhe në fshatin Poslisht dhe në Pllanjan.

Është bërë furnizimi me pajisje mjekësore, pajisje laboratorike dhe me karrige stomatologjike. Kemi bërë riparimin e objekteve shëndetësore. Është bërë pajisja me inventar të imtë me mobile, si dhe ljerja e objekteve shëndetësore.

Gjatë vitit kemi pajisur të gjitha ambulancat me kompjuterë, kemi blerë edhe një autoveturë për punëtorët shëndetësorë, mjekët dhe teknikët të cilët shkojnë për të punuar në ambulancat e mjekësisë familjare nëpër fshatra të komunës sonë.

Kemi pranuar si dhuratë një veturë me pajisje komplete mjekësore për ndihmën e shpejtë nga Qeveria e Luksemburgut.

Kemi pajisur QKMF-në me aparaturë më moderne që sot gjendet në tregun evropian, siç është, aparati Ortopan, Ultratingulli për gjinekologji, ultratingulli për pediatri. Kemi punësuar 18 punëtorë të rinj, 15 mjekë, 2 infermierë dhe 1 punëtor teknik.

Vizitat sistematike për kontrollin e shëndetit të fëmijëve tanë në shkolla jemi duke e realizuar që nga viti 2008. Kontrollimin sistematik të nxënësve e bëjmë në klasat e para, të pesta dhe klasat e nënta.

Punëtorët e QKMF-së, kanë marrë pjesë në seminare, konferenca e kongrese të punëtorëve shëndetësorë, në vende të ndryshme evropiane, edukimi specialistik i mjekëve është permanent dhe studimet postdiplomike në mjekësinë familjare, janë objektiv i vazhdueshëm yni.

Gjatë vitit 2010, kemi mbështetur financiarisht 60 pacientë me sëmundje të rëndë më nga 300 €. Një praktikë të këtillë jemi duke e vazhduar edhe në vitin 2011 dhe shpresojmë se do jetë praktike tradicionale dhe e përvitshme edhe në të ardhmen.

Drejtoria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, gjatë vitit 2010, ka ngritur 10 serra me nga 240 metër katror, ka bërë ndërtimin e 15 stallave për lopë me kapacitet 5-10 krerë. Ka riparuar rrugë fushore, ka bërë ndërtimin e pendës për ujitjen artificiale të tokave bujqësore në Smaç. Ka subvencionuar mbjelljen e 600 hektarëve me grurë dhe misër duke ua dhënë fermerëve farën gratis.

Drejtoria e Bujqësisë, ka bërë dezinfektimin dhe deratizimin e qytetit, eliminimin e qenve endacakë, vaksinimin e qenve kundër tërbimit.

Është realizuar manifestimi - Qethja e deleve 2010, në komunën tonë. Kemi ndihmuar bujqit që të mbjellin 23 hektarë me pemë. Janë organizuar seminare, trajnime, këshillime të ndryshme me interes për zhvillimin sa më të mirë të bujqësisë. Është bërë riparimi i kanalit të ujitjes në Lubizhdë, riparimi i kanalit të ujitjes në Serbicë të Ulët. Është bërë pastrimi i shtratit të lumit Toplluha, që kalon nëpër Piranë. Kemi bërë rregullimin e kanalit të ujitjes të tokave bujqësore në Poslisht. Kemi bërë ndërtimin e basenit për ujë për bagëti në malin Pikëllim, në Koritnik, janë investuar mjete financiare aty, sepse është pjesë e thatë e maleve.

Kjo drejtori ka realizuar rehabilitimin e sistemit të ujitjes Petrovë – Trepeticë – Penda - Velezhë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kjo drejtori, ka bërë subvencionimin e lopëve qumështore dhe subvencionimin e deleve.

Është bërë pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura. Janë kontrolluar artikujt ushqimorë me prejardhje shtazore. Është bërë kontrollimi i kafshëve për therje. Janë kontrolluar mishtoret, thertoret, tregu i kafshëve, stacionet për grumbullimin e lëkurëve, qumështoret, barnatoret bujqësore dhe veterinare, feramat e pulave etj.

Rekapitullimi:

Investimet kapitale nga Kuvendi Komunal Prizren.....	339.685
Investimet, grandet dhe subvencionet nga MBPZHR.....	366.970
Totali i investimeve.....	706.655

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, në periudhën Janar-Dhjetor 2010, ka pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, për realizim të të drejtave pronësore, apo të drejtave të tjera personale, nga personat fizikë, juridikë, subjektet joqeveritare, AKM-ja, AKP-ja etj.

Lëndët e pranuar 14.779.

Aktvendime për bartje 1927.

Aktvendime për korrigjimin e emrave dhe mbiemrave 103.

Aktvendime për regjistrimin e hipotekave 300.

Aktvendime për çregjistrimin e hipotekave 140.

Vërtetime, certifikata 4505.

Copëtimi-ndarja fizike 245.

Incizimi i gjendjes faktike 168.

Ekspertiza gjyqësore 88.

Kopje të planit 1238.

Lista poseduese 5618.

Gjithsej 14330

Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka pranuar 1641 aktvendime, me të cilat janë miratuar kërkesat e palëve. Nga puna e kryer janë inkasuar në buxhetin e Komunës 36784 euro .

Për incizimin e gjendjes faktike në terren kemi pranuar 168 kërkesa, prej të cilave kemi zgjidhur 137, kërkesa, në procedurë kemi edhe 31 lëndë.

Nga lëndët kemi inkasuar në emër të shërbimeve të kryera në buxhetin e komunës 16340 euro.

Kërkesa për identifikimin dhe përkufizimin e patundshmërive deri më 31.12.2010, kemi pranuar 153 kërkesa. Prej tyre kemi zgjidhur 128, ndërsa 25 janë në procedurë, të refuzuara nuk ka asnjë.

Nga këto shërbime kemi inkasuar 16540 euro .

Gjatë vitit 2010, kemi pranuar 1238 kërkesa për dhënien e kopjeve të planit për patundshmëritë, ngastrat kadastrale, objektet, pjesët e objekteve, rrugët private dhe ato publike. Pas shqyrtimit të kërkesave dhe dokumentacionit si dhe hartave gjeomedike , planeve skicave me të cilat ka disponuar ky shërbim, i ka vendosur të gjitha kërkesat duke ju dhënë kopje të planit.

Nga këto shërbime janë inkasuar 4321 euro.

Gjithashtu, në këtë vit kemi pranuar 5618 kërkesa për lëshimin e fletëve poseduese nga ana e qytetarëve, institucioneve, organeve qeveritare dhe joqeveritare. Pas verifikimit të shënimeve, brenda ditës të gjitha kërkesat janë zgjidhur duke ju lëshuar fletët poseduese të kërkuara. Asnjë kërkesë e paraqitur gjerë më tani nuk ka ngelur e perealizuar.

Nga lëshimi i fletëve poseduese janë inkasuar në buxhetin e Komunës së Prizrenit shuma prej 22672 euro.

Mjetet e inkasuara gjatë vitit 2010 nga drejtoria për gjeodezi e kadastër janë **234.430 euro.**

Të nderuar anëtarë të kuvendit, ju faleminderit për durimin dhe më lejoni që në kopje të fortë, ta pranoni raportin ekonomik-financiar vjetor, gjegjësisht të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2010.

Të gjithë anëtarët e kuvendit, OJQ-të dhe qytetarët që dëshirojnë të informohen në mënyrë më të përimtuar dhe analitike në lidhje me punët e realizuara gjatë vitit 2010, lutën që ta shfrytëzojnë mundësin elektronike të informimit përmes faqes elektronike të komunës sonë.

Faleminderit dhe suksese për të gjithë !

**REALIZIMI I BUXHETIT KOMUNAL
PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2010**

Të hyrat	Buxheti i miratuar 2010	Buxheti me ndryshime 2010	Arkëtimi I-XII-2010	Alokimi I-XII-2010	Shpenzime I-XII-2010	Gjendja 30-XII-2010	Ind. Ark/plan	Ind. Shp./ark
Të hyrat vetjake 2009		792,658	792,658	792,658	734,910	57,748	100	93
Donatorët e brendshëm 2009		52,916	52,916	52,916	52,916	-	100	100
Granti qeveritar 2010	20,685,520	21,661,557	21,661,557	21,661,557	21,118,202	543,355	100	97
Të hyrat vetjake 2010	4,964,235	5,114,235	4,434,433	4,434,433	3,033,560	1,400,873	87	68
Të hyrat nga donatorët e brendshëm. - Participimi 2010		329,861	329,861	329,861	231,527	98,335	100	70
Donatorët e jashtëm		427,853	427,853	427,853	28,634	399,219	100	7
Të hyrat e bartura nga 2009- donatorët e jashtëm		29,046	29,046	29,046	29,046	0.15	100	100
Totali	25,649,755	28,408,126	27,728,323	27,728,324	25,228,794	2,499,530	98	91

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme, shihet se mjetet e bartura nga të hyrat vetjake (792.658 €) dhe participimi 2009 (52.916 €) për periudhën janar -dhjetor janë alokuar në tërësi.

Nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009, gjatë vitit 2010, janë shpenzuar 734.910 €, kurse mjetet e participimit të bartura nga viti 2009 janë shpenzuar në tërësi.

Granti qeveritar për këtë periudhë të raportimit është alokuar në shumën prej 21.661.557 €. Shuma e shpenzuar nga ky burim i Buxhetit komunal është 21.118.202 €.

Sivjet për periudhën janar – dhjetor nga granti qeveritar janë alokuar 2.787.036 € më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (18.769.273 €).

Gjatë vitit 2010 të hyrat vetjake janë arkëtuar në shumë prej 4.434.433 €, sa edhe janë alokuar . Nga kjo shumë janë shpenzuar 3.033.560 €, pra 68% e shumës së arkëtuar.

Në vitin 2009 në të njëjtën periudhë të raportimit si të hyra vetjake janë arkëtuar 4.342.301 €. Krahasuar me realizimin e të hyrave vetjake të vitit paraprak, të hyrat vetjake sivjet kanë shënuar një rritje në realizim për rreth 2 %.

Nga të hyrat prej participimit me popullatën është arkëtuar shuma prej 329.861 € kurse janë shpenzuar 231.527 € .

Në vitin paraprak nga ky burim i të hyrave janë arkëtuar 371.897 €, pra 42.018 € më shumë se sivjet.

Nga të hyrat e alokuara nga donatorët e jashtëm prej 427.853 € janë shpenzuar 28.634 €.

Të hyrat e bartura nga donacionet e vitit të kaluar në shumën prej 29.046 € (për ZLK-nga UNDP shuma prej 25.205,74 € , për Shërbime Publike-mbrojtje civile nga Internat. Civil Office –ICO shuma prej 3.840 € dhe 0.15 për Shëndetësinë Primare nga Organizata Botërore e Shëndetësisë) janë shpenzuar pothuajse tërësisht.

Të ardhurat totale të alokuara të buxhetit komunal për vitin 2010 arritën rreth 27,728,323€ , nga 28,408,126 të parashikuara, duke u shpenzuar 25,228,794 € ose 91 % në krahasim me shumën e arkëtuar (27,728,323 €) .

Të hyrat e tërësishme të alokuara për vitin 2010 (27,728,323 €) janë për 2,914,664 € më shumë se në vitin paraprak. Në vitin paraprak të hyrat e tërësishme të alokuara kanë qenë **24,813,660 €**.

TË HYRAT VETJAKE TË BUXHETIT KOMUNAL PER PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2010

	Planifikimi 2010	Realizimi I-XII-2010	Ind.
Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet	591,000	612,168	104
Liç. për lojrat zbav., pije alkoolike, rekl., shpallje etj./Lejet	60,000	59,095	98
Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit	938,700	342,083	36
Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	308,000	208,035	68
Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	27,871	14,926	54
Shfrytëzimi i pronës komunale	500,000	410,616	82
Pagesat në lidhje me automjetet	881,300	796,657	90
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	222,300	269,168	121
Tatimi në pronë	1,080,000	1,167,778	108
Të ardhurat e tjera	155,064	247,136	159
Të ardhurat nga shërbimet shëndetësore	200,000	191,681	96
THV Arsimi	150,000	115,091	
Totali i të hyrave vetjake	5,114,235	4,434,433	87

Në tabelën e mësipërme janë dhënë të hyrat vetjake të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2010, të kategorizuara në bazë të grupeve.

Shuma e tërësishme e realizuar e të hyrave vetjake komunale (pa donacionet) për këtë periudhë të raportimit është **4,434,433 €** .

Të hyrat vetjake komunale për vitin 2010 prej 4,434,433 € së bashku me shumën e arkëtuar të participimit prej 329,861 € dhe donacionit prej 427,853€ arrijnë shumën prej 5,192,147 €.

Në tabelën e mëposhtme kemi një pasqyrë të realizimit të të hyrave sipas drejtorive


	Planifikimi	Realizimi I-XII-2010	%
Administrata dhe Personeli	746,300.00	707,949.22	94.86
Inspeksioni	20,871.00	13,606.36	65.19
Buxheti dhe Financat	1,580,000.00	1,712,289.05	108.37
Shërbimet Publike , Mbrojtja civile, Emergjencia	1,506,364.00	1,385,775.40	91.99
Zyra e Komuniteteve		22,773.75	
Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural	25,000.00	26,579.80	106.32
Kadastër dhe Gjeodezi	308,000.00	208,034.75	67.54
Planifikim Urban dhe Mjedisi	977,700.00	438,304.74	44.83
Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	200,000.00	191,681.00	95.84
Kulturë, Rini dhe Sport		366,761.82	
Arsim dhe Shkencë- Administrata	150,000.00	118,391.00	244.51
Gjithsej	5,514,235.00	5,192,146.89	94.16

Sqarim: Shuma e planifikuar në bazë të drejtorive (5,514,235.00 €) është shuma e të hyrave të planifikuara prej 5.114.235 € e rritur për shumën e participimit të planifikuar për vitin 2010 prej 400.000 €.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë krahasuese në mes të kategorive të të hyrave vetjake të Komunës për vitet 2009-2010.

	2009	I -XII-2009	2010	I-XII-2010
Licencat komer. dhe të biznesit/Lejet	580,000	611,803	591,000	612,168
Lic. për lojra zbav., pije alkoh.,rekl.	15,000	51,349	60,000	59,095
Shfryt. i tokës dhe lejet e ndërtimit	535,000	745,842	938,700	342,083
Inspek. i tokës dhe akt. gjeod.	250,000	239,338	308,000	208,035
Shërb.e inspek. shënd. dhe të sig.	15,000	24,484	27,871	14,926
Shfrytëzimi i pronës komunale	350,000	390,836	500,000	410,616
Pagesat në lidhje me automjetet	750,000	739,899	881,300	796,657
Certifikatat dhe dok. zyrtare	245,000	244,757	222,300	269,168
Tatimi në pronë	850,000	930,507	1,080,000	1,167,778
Të ardhura e tjera komunale	158,500	200,775	155,064	247,136
Te ardhurat nga shërb. shënd.	200,000	162,712	200,000	191,681
Të ardhurat nga Arsimi			150,000	115,091
Gjithsej:	3,948,500	4,342,302	5,114,235	4,434,433

Ecuria e të hyrave vetjake sipas muajve për periudhën janar-dhjetor 2010 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



PASQYRA E TË DALAVE TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2010

Shpenzimet	Buxheti i miratuar 2010	Buxheti me ndryshime 2010	Alokimi I-XII-2010	Shpenzimet I-XII-2010	Gjendja 30-XII-2010	Ind.
Pagat	10,162,744	11,271,443	11,250,649	11,129,125	121,524	99
Mallrat dhe shërbimet	2,205,449	2,498,412	2,475,978	2,339,390	136,588	94
Shpenzimet komunale	551,769	658,898	658,898	616,552	42,346	94
Subvencionet	350,000	382,003	382,003	372,004	9,999	97
Investimet kapitale	12,379,793	13,597,370	12,960,796	10,771,722	2,189,074	79
Totali	25,649,755	28,408,126	27,728,324	25,228,794	2,499,530	89

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të vitit 2010 kanë arritur në 25.228.794 € ose 89% nga 28.408.126 € të parashikuara për vitin 2010 .


Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shpenzimet e buxhetit komunal kanë qenë 23.799.012 € ose 97 % e shumës së planifikuar prej 24.415.617 €.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë krahasuese e shpenzimeve të Komunës, sipas kategorive, për vitet 2009-2010.

	2009	I -XII-2009	2010	I-XII-2010
Pagat	10,283,683	10,111,816	11,271,443	11,129,125
Mallrat dhe shërbimet	2,180,471	2,145,014	2,498,412	2,339,390
Shpenzimet komunale	546,319	543,207	658,898	616,552
Subvencionet	353,340	346,555	382,003	372,004
Investimet kapitale	11,051,803	10,652,420	13,597,370	10,771,722
Gjithsej:	24,415,616	23,799,012	28,408,126	25,228,794

Sqarim: në shumën e planifikuar të të hyrave totale dhe të shpenzimeve të tërësishme janë të përfshira edhe mjetet e bartura nga viti paraprak, participimi i alokuar për vitin 2010 dhe donacionet.

Ecuria e shpenzimeve sipas muajve gjatë vitit 2010 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



This document was created with Win2PDF available at <http://www.daneprairie.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.